



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, Ligjit për Zonat Ekonomike , nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.05.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE
PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË ZONËN
EKONOMIKE "PARKU INDUSTRIAL" NË QYLAGË

Neni 1
Përbërja e Komisionit

Formohet Komisioni i ankesave për shqyrtimin e ankesave të subjekteve afariste në zonën ekonomike "Parku industrial" në Qylagë (në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve:

1. Imri Semetishti, nga ekzekutivi i komunës, kryesues
2. Bekim Shabani, nga ekzekutivi i komunës, anëtar
3. Majlinda Sylejmani, nga kuvendi i komunës, anëtare
4. Arsim Jashari, nga kuvendi i komunës, anëtar
5. Erblina Salihu, nga shoqëria civile , anëtare

Neni 2
Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i lidhur me mandatn e Kuvendit të Komunës.

Neni 3
Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëj shqyrtimin e ankesave të cilat do të parashtrihen nga subjektet afariste ofertat e të cilëve janë refuzuar nga Komisioni

vlerësues për t'u vendosur në Zonën Ekonomike "Parku Industrial " në Qylagë brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor.

Komisioni i ankesave kryen punët dhe detyrat në pajtim me me dispozitat e Ligjit për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike , kriterëve të përcaktuara në konkursin publik si dhe dispozitave tjera ligjore përkatëse.

Neni 5

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me aktë nënligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Konkursi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa. Kompenzimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompenzimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe akteve tjera nënligjore me të cilat rregullohet kjo çështje nëse të njëjtat nuk bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

15 Nr. 330/01-28093

Lipjan, më 31.05.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azem

